

qika

Nr
01

QENDRA PËR
INFORMIM, KRITIKË
DHE AKSION




**POLITIKA ËSHTË
PUNË PËR GRA!**

POLITIKA ËSHTË PUNË PËR GRA!

Konstatimi se “politika është punë për burra”, është përjashtues ndaj grave.

Duke parë sferën publike si hapësirë për veprim vetëm të burrave, gratë në Kosovë nuk po arrijnë as ta shohin si mundësi angazhimin për çështje publike.

Në këtë drejtim, subjektet politike janë treguar mjaft të ngurta duke mos punuar fare në programe gjithëpërfshirëse. Shifrat e larta të papuniësisë dhe jo-aktivitetit në tregun e punës, pamundësitë për të trashëguar pronë, kujdesi ndaj të tjerëve dhe punët e papaguara janë ndër arsyet kryesore që gratë vazhdojnë të mbresin të pa përfshira në jetën politike.



Kur flitet për gruan dhe angazhimin politik të saj, me apo pa vetëdije ekziston një tendencë që të diskutohen si dy kategori të ndryshme, të ndara. Zakonisht temës së tillë i referohemi si “Gratë dhe Politika”, ndonëse nuk veprojmë në të njëjtën mënyrë kur flasim për burrat politikanë. Aq u vlerësohet angazhimi, sa jo rrallë herë edhe në diskutime publike quhen “burrështetas”.

Megjithëse diskutimi për përfshirjen e grave në jetën publike është shumë më i gjërë dhe nuk ngecë tek shifrat e përfaqësimit, statistikat në nivel vendor dhe global tregojnë shumë për pabarazinë.

Parlamenti Evropian aktualisht përbëhet 63% prej burrave. Kjo nënkupton pothuajse 200 anëtarë më shumë burra sesa gra brenëda Parlamentit Evropian. Në 10 shtetet anëtare të BE-së, siç janë Bullgaria, Republika Çeke, Qiproja, Irlanda, Letonia, Hungaria, Malta, Rumania dhe Slovacia, burrat përbëjnë të paktën 80% të parlamenteve kombëtare. Në të gjithë BE-në, 85% e kryetarëve të bashkive janë burra.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura në qershor të këtij viti në Kosovë sollën rritje të numrit të grave deputete. Nga 120 ulëse sa ka gjithsej Kuvendi i Kosovës, 36.6% e tyre tanë u takojnë grave deputete. Lëvizja Vetëvendosje përfaqësohet me 23 deputete, Partia Demokratike e Kosovës ka gjashtë deputete, Lidhja Demokratike e Kosovës pesë deputete, nga tre gra deputete kanë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lista Serbe si dhe katër deputete janë nga komunitetet tjera.

Në anën tjetër të gjitha komunat e Kosovës vazhdojnë të drejtohen nga burrat si dhe një numër shumë i madh i pozitave me rëndësi shtetërore, përfshirë zëvendësministrat dhe nënkyetarët e komunave.

QIKA ka analizuar nga perspektiva feministë fushatën e fundit të zgjedhjeve parlamentare të mbajtura në shkurt të këtij viti, ku përmes monitorimit e analizës ka argumentuar se gratë përgjithësisht ishin të nën-përfaqësura në lista zgjedhore, debate televizive e tubime publike si dhe çështjet gjinore ishin të pa përfshira në programet zgjedhore të subjekteve politike. Të dhënët e mbledhura janë analizuar dhe komentuar përmes intervistave me gra politikane të subjekteve më të mëdha në Kosovë. Në mënyrë që kjo analizë të jetë sa më e plotë, QIKA ka tentuar të realizoj intervista edhe me shefat e shtabeve të partive politike në zgjedhjet e fundit parlamentare por përvçe Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës nuk i janë përgjigjur ftesës sonë.

QIKA

Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion – QIKA është organizatë e themeluar në gusht të vitit 2020, që për qëllim ka mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të barabarta për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kjo nismë vjen si revoltë ndaj shtypjes që përjetojnë gratë në familje, punë, rrugë e institucione. Përprojekja jonë është të praktikojmë dhe zhvillojmë një feminizëm gjithëpërfshirës, ku gratë e të gjitha zonave, moshave, etnive, klasave, orientimeve seksuale dhe religjioneve të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të jetojnë pa shtypje dhe diskriminim.


Përmes aktivizmit si formë e gjithëpërfshirjes dhe gazetarisë së mjet i rëndësishëm informimi, kemi synim që të bashkojmë zërat e grave dhe burrave për barazi dhe të inkurajojmë institucionet e qytetarët që ta konsiderojnë barazinë gjinore si kusht të domosdoshëm për zhvillimin shoqëror.

Në kuadër të këtij angazhimi kemi krijuar edhe platformën mediale feministë www.qika.org; një hapësirë tërësisht e re informimi, diskutimi dhe leximi që tenton t'i jap vëmendje perspektivave të marginalizuara të vajzave dhe grave në Kosovë.

Drejtorë Ekzekutive dhe kryeredaktore:
Leonida Molliqaj

Menaxhere e Programit:
Donjeta Morina

Hulumtuese:
**Greta Avdyli, Riola Morina
dhe Medinë Dauti**



KUJDESI NDAJ FAMILJES DHE MUNGESA E TË ARDHURAVE PO IZOLON GRATË NË SFERËN PRIVATE

Para se flasim për mungesën e grave në pozita drejtuese, apo numrit të vogël të aktivisteve politike, ne duhet të shtrojmë diskutimin në atë mënyrë që t'i përgjigjemi pyetjes: Pse është aq e vështirë dhe sfiduese përfshirja e vajzave dhe grave në aktivitete politike dhe përgjithësisht në sferën publike?

Në një raport të publikuar nga National Democratic Institute dëshmohet se ka përmirësim në perceptimin e udhëheqjes nga gratë dhe në të kuptuarit e barrierave me të cilat përballen gratë. "Shumica e publikut beson se përgjegjësitë familjare janë arsyaja pse nuk ka më shumë gra në udhëheqësi. Një shumicë gjithashtu vëren se ngurrimi nga burrat për të parë gratë që përparojnë dhe format më të gjera të diskriminimit gjinor ishin shkaqet kryesore të pabarazive gjinore në udhëheqje", thuhet në raport.

Në Kosovë 32.3% e grave janë të papuna, ndër-kohë 79.2% e grave janë jo aktive në tregun e punës (që nënkupton që as nuk janë duke kërkuar vend pune). Duke qenë të varura finançarisht nga burrat e familjes, gratë obligohen që të marrin përsipër të gjitha punët e shtëpisë e kujdesin ndaj fëmijëve dhe të moshuarve, e duke pasur barrën kryesore për punët e papaguara ato nuk po arrijnë as të kërkojnë vende pune. Edhe ato pak gra që janë të punësuara, kryejnë poashtu punët e shtëpisë, kjo për shkak të ndarjes tradicionale të roleve gjinore.

Gratë në politikë shpesh përballen me mungesën e mbështetjes nga familjet e tyre dhe kjo jo rrallëherë dekurajon ato që të synojnë pozita udhëheqëse.

Sibel Halimi, zëdhënëse politike e Lidhjes Demokratike të Kosovës, shpjegon se botëk-uptimet e krijuara për vajzat gjatë procesit të



VAJZAT RRITE ME IDENË QË MË SHUMË JANË TË PËRSHTATSHME PËR SFERËN PRIVATE DHE KËTO STEREOTIPE E PARAGJYKIME PASTAJ PENCOJNË GRATË QË NË MOSHË MADHORE TË ANGAZHOPEN POLITIKISHT."

SIBEL HALIMI - LDK



SHUMË HERË GJATË FUSHATAVE ZGJEDHORE KU KËRKOHET TË LËVIZET NGA NJË QYTET NË TJE TRIN, GRATË KANË MË SHUMË PENGEZA TË PËRFSHIRJES PËR SHKAK TË OBLIGIMEVE FAMILJARE SEPSE DIHET QË ATO NË PËRGJITHËSI SHPENZOJNË MË SHUMË KOHË PËR FAMILJEN."

ARBËRIJE NACAVCI, LVV



JU E DINI SE NË KOSOVË ATA QË KANË PARE JANË BURRA DHE ATA QË SHKOJNË NË PËR EMISSIONE JANË KRYESISHT BURRA. DOMËTHËNË AQ SA KE PAS PARE, AQ KE ME PAS BILLBORDA."

VALDETE IDRIZI - PDK

socializmit i pengjnë ato përfshirje në politikë.

"Vajzat rriten me idenë që më shumë janë të përshtatshme për sferën private dhe këto stereotipe e paragjykime pastaj pengjnë gratë që në moshë madhore të angazhohen politikisht. Historikisht politika është konsideruar si terren i burrave. Një terren i cili duket sikur është pronësuar nga kjo gjini dhe në këtë mënyrë ky dimension i rëndësishëm i shoqërisë ka krijuar një ambient shoqëror maskilinist ku gratë ndihen të pafuqishme për t'u përfshirë", thotë Halimi.

Duke pasur parasysh të gjitha këto vështirësi, duke ditur kohën dhe përkushtimin që kërkon angazhimi në parti politike dhe gara zgjedhore, gratë shpesh e kanë thuajse të pamundur të bëjnë jetë aktive në politikë. Sipas raportit të Demokracisë në Veprim (DNV), sa i përket pjesëmarrjes së grave në fushatë zgjedhore dhe pjesëmarrjes së tyre si folëse nga subjektet politike që ato kanë përfaqësuar, vërehet një diskrepancë e theksuar në raport me burrat.

Pjesëmarrja e grave në fushatë si dhe pjesëmarrja e tyre si folëse ka qenë tejet e ulët, respektivisht nën 30%-shin e ngjarjeve të monitoruara nga DNV. Gratë kanë qenë prezente në ngjarje të fushatës zgjedhore vetëm 24% në raport me burrat.

"Vërejmë një rritje të lehtë të numrit të grave të cilat kanë qenë folëse gjatë fushatës zgjedhore, mirëpo kjo rritje është tejet e vogël në raport me pjesëmarrjen e përgjithshme të grave në ngjarjet e vëzhguara, ku gratë folëse të subjekteve politike kanë qenë vetëm 5% më lartë, apo 27% në raport me burrat", thuhet në raport.

Numrat ishin relativisht të njëjtë edhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019. Sipas DNV, në të gjitha aktivitetet e organizuara nga subjektet politike, vetëm 25.3% e folësve kanë qenë gra,

derisa numri i pjesëmarrësve gra në fushatë zgjedhore ishte vetëm rreth 25%.

Arbërie Nagavci, Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, thotë se sfidat e përfshirjes së grave në gara zgjedhore janë dukshëm më të shumta se sa të burrave. Ndër të tjera Nagavci përmend si vështirësi për gratë politikane presionin dhe sulmet që ndodhin në rrjete sociale apo në media. Sipas një hulumtimi të publikuar në Balkan Insight, dhuna online ndaj grave në Kosovë po e dëmton gatishmërinë e tyre për t'u angazhuar në jetën politike dhe publike.

“Shumë herë gjatë fushatave zgjedhore ku kërkohet të lëvizet nga një qytet në tjetrin, gratë kanë më shumë pengesa të përfshirjes për shakak të obligimeve familjare sepse dihet që ato në përgjithësi shpenzojnë më shumë kohë për familjen. Poashtu ekonomikisht gratë janë në pozitë më të pafavorshme se burrat, ku një pjesë e konsiderueshme e grave kanë vështirësi në aspektin logistik, disa prej tyre nuk kanë leje të vozitjes, disa nuk kanë veturë të veten, disa kanë problem të udhëtojnë me të tjerët etj.”, shpjegon Nagavci.

Paratë kanë një ndikim jashtëzakonisht të madh në garat zgjedhore. Në këtë drejtim, gratë kandidate janë gjithmonë më pak të përfshira në materialelet elektorale. Kjo përfaktin se fondet shpesh menaxhohen nga burrat brenda partive por edhe në ato raste kur ndahen barabartë, ato janë të pamjaftueshme për realizimin e një fushatë se-rioze, duke pasur parasysh situatën ekonomike të grave.

Gratë në Kosovë përgjithësisht kanë më pak të ardhura financiare andaj arrijnë të "blejnë" më pak hapësirë për veten, e si rezultat përfshihen në garë të pabarabartë zgjedhore me burrat. Billbordat, spotet televizive apo reklamat në portale ishin të dominuara dukshëm nga burrat edhe në zgjedhjet e fundit parlamentare.

“Përveç fotografive që janë realizuari për të gjithë kandidatët, të tjerat është dashur të mbulohen vet varësish sa e ke buxhetin. Ju e dini se në Kosovë ata që kanë pare janë burra dhe ata që shkojnë nëpër emisione janë

kryesish burra. Domëthënë aq sa ke pas pare, aq ke me pas billborda”, shpjegon Valdete Idrizi deputete e Partisë Demokratike të Kosovës.

Time Kadrijaj, deputete nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e konsideron si vendim personal shumën e kostos që shpenzon një kandidat për fushatë zgjedhore.

“Secili deputet e mendon veç e veç qysh e bon fushatën zgjedhore, a don me bo reklama ma shumë, a don me bo billborda më shumë apo si intereson hiç, është vendim personal. Unë nuk jam ijtare e billbordave se nuk besoj që billbordi ka me m'sjellë votë”, thotë ajo.

Demokraci për Zhvillim (D4D) ka publikuar këtë vit një raport mbi financimin e fushatës zgjedhore nga gratë kandidatë ku ka gjetur se asnëjë nga subjektet politike nuk kanë rregullore të brendshme për fonde të veçanta që mbështesin gratë kandidate në fushatë zgjedhore.

Sipas këtij rapporti 75% e të anketuarave ndjehen të diskriminuara brenda subjekteve politike në procesin e ndarjes së resurseve humane dhe financiare gjatë fushatës zgjedhore.

Në një hulumtim të publikuar nga Preporr mbi zgjedhjet parlamentare të vitit 2017 vërehet se burrat kandidatë kanë investuar dukshëm më shumë në materiale promovuese se sa gratë kandidate.

“Preporr ka gjetur se nga 746 reklama në portalet informative, 82.31% reklamonin kandidatët burra dhe vetëm 17.69% gratë. Rezultate të ngjashme kanë dalur edhe nga monitorimi i reklamave në gazetat ditore. Nga 218 reklama të monitoruara për nëntë ditë fushatë (me 4 qershor nuk ka pasur gazeta), vetëm 19.27% promovonin gratë kandidate ndërsa 80.73% burrat. Përveç kostos së prodhimit të një spoti reklamues, kandidatët kanë paguar shumë edhe për hapësirën në televizione. Meqë reklamat e tillë kanë kushtuar shumë, gratë kandidate kanë arritur të janë shumë pak prezente në televizione. Nga 40559 sekonda reklama të monitoruar, Preporr ka gjetur se 88.36% e tyre promovonin burrat kurse 11.64% gratë”, thuhet në këtë hulumtim.

75%


e të anketuarave ndjehen
të diskriminuara brenda
subjekteve politike në
procesin e ndarjes së
resurseve humane dhe
financiare gjatë
fushatës zgjedhore
– D4D

GRATË JASHTË LISTAVE ZGJEDHORE

Trembëdhjetë vite pas konsolidimit të institucioneve të Republikës së Kosovës janë mbajtur 5 palë zgjedhje parlamentare, e 8 sosh nga paslufta deri më tash. Pa marrë parasysh prensionin e organizatave joqeveritare dhe bashkësisë ndërkontinentare, partitë politike kanë vazhduar të kandidojnë gra në lista zgjedhore vetëm sa për ta përbushur obligimet ligjore. Gjatë kësaj periudhe gratë kandidate për deputete e kanë dëshmuar shumë herë cilësinë por

edhe mbështetjen që e gjelqen nga elektorati. Mirëpo, kjo asnjëherë nuk ka mjaftuar që partitë politike të arrijnë përfaqësim të barabartë gjinor në listat zgjedhore.

Edhe në zgjedhjet e fundit parlamentare të gjitha subjektet kanë shkelur Ligjin për Barazi Gjinore që parashtë përfaqësim 50/50 të burrave dhe të grave. Në anën tjetër renditja në lista zgjedhore ka vazhduar me trendin thuajse të njëjtë tek të gjitha partitë ku çdo e treta është grua, ndërkohë që burrat kishin numra kyç e më të vjetrash.



Zëdhënësi për media në Aleancën për Ardhmérinë e Kosovës, Lulzim Blaka, tregon se partia të cilës i përket zakonisht ka problem përfaqësim të barabartë në nivelin e degëve më shumë se sa në qendër. Sipas tij në tubime të kësaj partie pjesëmarrja e grave nuk është ulët, por kur vie puna tek kandidimi gjërat ndryshojnë.

“Sa i përket angazhimit të grave direkt në politikë është goxha problem, rrallëherë kalohet pragu 30%. Na në zgjedhjet e kalume e kemi kalu pragun për një kandidate, kena dashtë ma shumë por nuk ka pasë interesim. Jo që nuk është jep mundësia por nuk ka pasë interesim”, thotë Blaka. Sipas tij është urgjente që të bëhet harmonizimi i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe atij për Barazi Gjinore në mënyrë që partitë ta kenë me të qartë obligimin ligjor.

Të njëtin mendim ndan edhe Time Kadrijaj. “Ndonjëherë gratë hezitojnë me qenë pjesë aktive e politikës pasi që mjaftohen me një punë dhe me iu kthy aktivitetit familjar, shtëpiak dhe ndonjëherë hezitojnë me qenë pjesë aktive e politikës”, deklaron ajo.

Edhe Nagavci fajin për mospërfaqësim të barabartë ia lë edhe hezitimit të grave për tu përfshirë në lista zgjedhore. “Ne kemi insistuar mjaftueshmë që me pas numër më të madh të grave kandidate, por këtu ka qenë shumë shpesh hezitimi nga ana e grave”, thotë ajo.

Por Vlora Dumoshi, deputete e Lidhjes Demokratike të Kosovës, thotë se është shumë dekurajuese mungesa e përfshirjes së grave në lista zgjedhore si dhe renditja e pa drejtë brenda listave.

Edhe në zgjedhjet lokale që pritet të mbahen në 17 tetor të këtij viti, gratë ngelën të nënpërfaqësuara në lista zgjedhore për këshilltare komunale, ndërkohë nga mbi 160 kandidatë për kryetar të Komunave, partitë politike shqiptare ua kanë besuar kandidaturën vetëm 9 grave për të udhëhequr me komunat e Kosovës.

Para zgjedhjeve qendrore të vitit 2019, përmes një deklarate publike, Avokati i Popullit ka theksuar zëshëm që dispozitat e Ligjit për Barazi Gjinore kanë përparësi ndaj dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Kjo vlen për dy arsyesh kryesore: 1. Ligji për Barazi Gjinore është ligj i veçantë sa i përket garantimit,


mbrojtjes dhe promovimit të barazisë gjinore, dhe ligjet e veçanta kanë përparësi mbi ligjet e përgjithshme, dhe 2. Ligji për Barazi Gjinore është i miratuar më vonë (2015) krahë Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe detyrimisht kërkon zbatim.

Sipas raportit të publikuar nga NDI për pjesëmarrjen e grave në politikë, partive në Kosovë shpesh u mungojnë proceset e qarta e të formalizuara për identifikimin, propozimin, përgjedhjen dhe vendosjen e kandidatëve në listat e tyre, duke e bërë veçanërisht të vështirë për gratë që të navigojnë nëpër procese joformale, të dominuara nga burrat.

“Kur u pyetën për këtë gjatë intervistave dhe grupeve të fokusit, shumica e përfaqësuesve të partive politike nuk ishin në gjendje të tregonin për procedurat e zyrtarizuara, të zbatuara në mënyrë të qëndrueshme. Ishte e qartë nga hulumtimi cilësor se për të përbushur kërkësën minimale për kuotën zgjedhore, shumë parti përgjedhin gratë kandidate në minutën e fundit dhe këshitu duke i kushtuar kohë dhe burime të pamjaftueshme për t'u mundësuar atyre të drejtojnë fushata efektive. Përpjekjet përfshirjen e grave përtej kërkësave të kuotës duket se burojnë nga motivimet personale dhe jo institucionale, me një të intervistuar burrë që sugeron se “ende nuk jemi në një vend ku gratë do të ngrihen dhe do të zënë vende”, thuhet në raport.

Duke pasur parasysh ritmin e ngadaltë me të cilin në të kaluarën rritje numri i grave në pozita vendimmarrëse, janë shtuar thirrjet për metoda më efikase për të arritur një ekuilibër gjinor në institucionet politike. Kuotat paraqesin një mekanizëm të tillë. Futja e sistemit të kuotave për gratë përfaqëson një kapërcim cilësor në rrafshin e përfaqësimit më të barabartë. Edhe pse rëndësia e kuotës gjinore shpesh ishte kritikuar dhe kundërshtuar, ndikimi i saj në përfshirjen e më shumë grave në Kuvendin e Kosovës është shumë i vjetshëm. Në zgjedhjet e fundit parlamentare numri i grave deputete që fituan pa ndihmën e kuotës u rrit dukshëm për dallim prej viteve të tjera. Zbatimi i legjislacionit për kuotën gjinore ka hapur rrugë për më shumë gra politikane. Në disa raste gratë të cilat herën e parë e kanë fituar mandatin e deputetës përmes kuotës, në zgjedhjet e tjera janë radhitur ndër deputetët më të votuar.

KRAHASIMI I DEPUTETEVE TË ZGJEDHURA ME VOTË DHE ATYRE ME KUOTË (2007-2021)



DEBATET E BURRAVE

Pjesëmarrja e grave në debatet televizive është një dëshmi tjeter për garën e pabarabartë mes grave e burrave në proceset zgjedhore. Kjo formë e pabarabartë e përfaqësimit tregon se si partitë politike gjatë fushatës zgjedhore u kanë dhënë hapësirë burrave më shumë se sa grave që të prezantojnë qëndrimet e tyre politike dhe përforcon paragjykimin se mendimet e grave për çështje politike kanë pak rëndësi.

Para fillimit të fushatës QIKA u ka dërguar një letër të hapur partive politike duke kërkuar që gratë politikane të kenë sa më shumë paraqitje publike gjatë fushatës. Megjithatë,

edhe pas kërkesës tonë, gjatë fazës së monitorimit kemi hasur në shpërputhje të përfaqësimit të grave kandidate krahasuar me burrat kandidatë. QIKA ka monitoruar debatet televizive për pesë kanale televizive të cilat kanë organizuar më së shumti debate gjatë fushatës për zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare në Kosovë. Periudha e monitorimit pasqyron komplet ditët e fushatës zgjedhore nga data 3 shkurt deri më datën 12 shkurt dhe të dhënët përfshijnë vetëm përfaqësuesit e subjekteve politike që ishin garuese në këto zgjedhje. Sipas të dhënave të nxjerra, në tërësi partitë politike në këto emisione janë përfaqësuar me 57 burra dhe vetëm 10 gra.


PJESËMARRJA E PËRFAQËSUESVE TË PARTIVE POLITIKE NË DEBATE TELEVIZIVE SIPAS CJINISË



Emisionet: Debat Plus, Debat, Pressing, Politiko, Rubikon
Periudha: 03.02.2021-12.02.2021



MINUTAT QË KANË PASUR GRATË DHE BURRAT KANDIDATË NË KRONIKA ZGJEDHORE



Në debatet televizive të monitoruara nga data 13 janar deri me datë 12 shkurt, përqindja e grave kandidate pjesëmarrëse është vetëm

20%

ndërkaq në spote reklamuese përqindja e grave pjesëmarrëse është

16%

Burimi: DNV

Nita Luci, profesore në Fakultetin Filozofik, thotë se shpeshherë producentëve ose gazetareve nuk iu bien ndërmend gratë të cilat mund të ftohen në debate televizive por në anën tjetër Luci thotë se kjo tregon edhe për injorim dhe mungesë besimi për mendimet e grave.

“Ne në përgjithësi si shoqëri kemi ende problem me iu besu grave për çka ato thonë, me iu besu se ato kanë dije, kanë njohuri edhe munden me artikulu ide”, thotë ajo.

Luci argumenton se veshi jonë është shumë pak i trajnuar në përgjithësi për të dëgjuar një zë dhe tingull femërор, kjo për shkak se hapësira publike e mediatike sipas saj është e dominuar prej një zëri dhe një perspektive shumë më mashkulllore. Sipas saj kjo ndikon tek gratë, çofshin ato analiste apo politikane që të pyesin veten sa herë që ftohen në debate televizive “Me cilin zë kam me folë unë? Qysh kam me e artikulu veten? A kam me ju nënshtru në njëfarë mënyre diskursit ekzistues apo ndoshta kam me synu me e thy pak qatë strukturë për me ofru një formë tjetër të të folurit, argumentimit apo logjikës”.

Demokracia në Veprim, ka bërë matjen për kronika zgjedhore, me ç’rast të gjeturat tregojnë se minutat që kanë pasur gratë kandidate në kronika janë vetëm 7% në krahasim me 93% për burra. Në debatet televizive të monitoruara nga data 13 janar deri me datë 12 shkurt, përqindja e grave kandidate në këto debate është vetëm 20%, ndërkaq në spote reklamuese përqindja e tyre është 16%.

Arbëria Nagavci nga LVV thekson se faktor tjetër që ndikon në nën-përfaqësimin e grave në debatet politike është edhe pritshmëria e shoqërisë mbi dukjen e tyre. Sipas saj kjo krijon një presion mbi to dhe mund të jetë faktor që ndikon në hezitim e tyre për të pasur paraqitje mediatike.

“Besoj që në shumicën e rasteve edhe gratë vetë presin të jenë të përgatitura për një paraqitje në emision televiziv, por në anën tjetër edhe pritshmëritë e të tjera të në rapport me gratë edhe gjykimi dhe vlerësimi i tyre për gratë është në kriterë më të larta, gjë që për burrat nuk ekziston. Mund të jetë edhe çështja e paraqitjes, pritshmëritë për aspektin fizik apo për pamjen e gruas janë më të larta”, shton ajo.



**NE NË PËRGJITHËSI SI
SHOQËRI KEMI ENDE
PROBLEM ME IU BESU
GRAVE PËR ÇKA ATO
THONË, ME IU BESU SE
ATO KANË DIJE, KANË
NJOHURI EDHE MUNDEN ME
ARTIKULU IDE.” –
NITA LUCI, PROFESORE NË UP**

Sipas Global Media Monitoring Project, që bën matjen e përfaqësimit të grave në media për çdo 5 vjet, gratë paraqiten në lajmet në internet dhe media të tjera dixhitale me



Sipas Valdete Idrizit, gratë asnjëherë nuk hezitojnë të marrin pjesë në debate televizive, mirëpo problemi qëndron se ato në të shumtën e rasteve nuk njoftohen me kohë dhe kështu tentohet që faji tu lihet atyre. “Unë mendoj që nuk ju është dhënë besimi sa duhet grave në përfaqësim”, deklaron ajo.

Në pyetjen se pse është vërejtur dukshëm diskrepanca mes burrave dhe grave në paraqitjet në debatet televizive, Lulëzim Blaka nga AAK i cili njëherit ka qenë edhe përgjegjës për pjesën e marrëdhënieve me publikun në zgjedhjet e fundit, shprehet se AAK si subjekt nuk ka bërë ndonjë diskriminim me bazë gjinore. Ai thotë se dërgimi i deputetëve në debatet televizive është bërë në bazë të temës së emisionit, me ç'rast janë dërguar profesionistët e fushës.

“Na s’kemi bo diskriminim absolutisht, por vetëm jemi shku me listë. Po kérkojnë ekonomist, kemi këqyrë për ekonomistë. Jena mundu me zgjedhë dikon që nuk ka qenë në debate të mëhershme me e dërgu. Nëse ka qëllu ndonjë grua ekonomiste në listë mundësinë ja kena jep, e kemi thirrë,

tjetër është se a ka pranu apo nuk ka pranu.” - pohon Blaka. Të njëjtën gjë e pohojnë edhe deputetet Vlora Dumoshi nga LDK dhe Time Kadrijaj nga AAK, duke thënë se paraqitjet në debatet politike bëhen në bazë të kualifikimit profesional dhe temës së përcaktuar për diskutim.

Ndërsa Sibel Halimi ndërlidhë perceptimet tradicionale të shoqërisë me politikën dhe median. “Media shpërfaqë një realitet i cili është i krijuar nga shoqëria por në anën tjetër nuk është e pafajshme në krijimin e kësaj gjendje që ekziston”, u shpreh ajo, duke shtuar se mediat duhet të kérkojnë nga partitë që të ftuar të jenë specifisht gratë politikane. Megjithatë, ajo pohon se LDK gjatë periudhës së fundit i ka kushtuar rëndësi tejet të madhe përfaqësimit të gruas, jo vetëm në kuptimin simbolik, por si aktere që ndihmon në zhvillimin e partisë.

Për Time Kadrijaj, takimet me elektoratin e saj janë shumë më të rëndësishme sesa pjesëmarrja në debatet televizive. Ajo pohon se ka qenë e ftuar por nuk ka pranuar ftesën për



shkak të agjendave elektorale të saj. "Meqenëse unë kom qenë deputete, kom qenë aktive, kom qenë nëpër debate televizive, kom thon jepnju hapësirë grave të reja që jon kah Prishtina se n'fund t'fundit mu publiku m'njeh që është i pesti mandate që jom deputete", tha ajo.

Sipas një studimi të realizuar nga Global Media Monitoring Project përgjatë 20 viteve në nivel global gratë përbënë vetëm 24% të njerëzve për të cilët lexojmë në gazeta, i shohim në media apo dëgjojmë në radio. Sipas Global Media Monitoring Project, që bën matjen e përfaqësimit të grave në media për çdo 5 vjet, gratë paraqiten në lajmet në internet dhe media të tjera dixhitale me 26%, ndërsa sa i përket kategorisë së lajmeve për politikën, gratë përbënë vetëm 16% të njerëzve që paraqiten në storiet mediatike.

Ndërlidhja mes grave politikane dhe përfaqësimit të tyre mediatik është prekur si çështje nga studiues të ndryshëm. Pavarësisht rritjes së konsiderueshme të numrit të grave politikane, ato mbeten të nën-përfaqësuara në botën e me-

dias. Kjo dukuri ndodhë edhe në vendet si Norvegji, që konsiderohet të ketë zhvillimin më të lartë sa i përket barazisë gjinore. Një studim i bërë në Norvegji tregon se vetëm 29% e politikanëve që paraqiten në lajme janë gra, pra 10% më pak sesa numri aktual i tyre që janë zgjedhur qoftë si përfaqësuese të qarkut, kryetare të bashkisë apo përfaqësuese parlamentare. Ndërsa, në Irlandë gjatë zgjedhjeve të vitit 2011 gratë përbënë rrëth një të tretën e paraqitjeve në panelet e diskutimit dhe kishin pasur në dispozicion vetëm 10% të kohës mediatike për të diskutuar mbi planet dhe strategjitet politike.

Nën-përfaqësimi i grave në media vërehet edhe në vendet jo perëndimore, siç janë Afrika Sub-Sahariane, Gana e Nigeria. Gratë politikane në këto vende praktikisht luftonin për të marrë vëmendjen mediatike dhe kur e arrin një gjë të tillë nuk merreshin parasysh arrijet e tyre, por diskutohej mbi benefitet që i kishte sjellë familjes pozita e tyre.

PROGRAMET E PARTIVE POLITIKE ADRESOJNË SIPËRFAQËSISHT PABARAZITË GJINORE

Pabarazia gjinore dhe diskriminimi ndaj grave janë ndër problemet kryesore zhvillimore të Kosovës. Si të tilla, ato duhet të janë pjesë thelbësore e programeve politike të partive politike që synojnë qeverisjen. Mirëpo, ndonjëherë për të ruajtur fuqinë dhe kontrollin, elita politike krijon tendencia për t'i mbajtur çështjet thelbësore jashtë rendit të ditës, në rastin tonë, çështjet gjinore. Ata që janë më afér procesit të politikave kanë kontrollin më të madh mbi çështjet që arrijnë të zënë vend në programin politik, e zakonisht ata janë burrat. Kësisoj shpesh ata përcaktojnë se si temat debatohen, në aspektin e rendit, kornizës dhe përbajtjes. Kjo ka ndikuar që shpesh politikat që përmirësojnë drejtpërdrejtë jetën e grave të mbresin jashtë agjendave politike.

“Pjesëmarrja e barabartë e grave në jetën politike luan një rol kryesor në procesin e përgjithshëm të përparimit të grave. Pjesëmarrja e barabartë e grave në vendimmarrje nuk është vetëm një kërkesë për drejtësi të thjeshtë ose demokraci, por gjithashtu mund të shihet si një kusht i domosdoshëm që interesat e grave të merren parasysh...”, thuhet në Deklaratën e Pekinit dhe Platformën për Veprim.

QIKA ka zhvilluar një analizë të shpejtë të programeve qeverisëse të partive politike nga perspektiva gjinore. Pavarësisht se vërehet një përmirësim në mënyrën e trajtimit të këtyre çështjeve, shumica e objektivave të programeve kanë vetëm fuqi deklarative, kështu duke pasur mungesë thuajse absolute të planeve konkrete se si këto objektiva do të adresohen. Ato parti të cilat përmenden dhunën në bazë gjinore apo dhunën në familje, fokusohen më shumë në trajtim të rasteve apo trajtim të të mbijetuarave të dhunës, por jo në parandalim. Në anën tjetër, ndihmesat e parapara financiare për gratë të cilat kanë fëmijë, nuk është se sjellin një përmirësim të gjendjes ekonomike të grave në të ardhmen. Tendenca për të mbështetur gratë vetëm përbrenda rolit të amësisë ka rrezik të ngujoj ato edhe më tutje në shtëpi me përgjegjësitë mbi punët e paguara. Përkundër gjithë këtyre shtjellimeve, aspekti tejet shqetësues që vlen për të gjitha subjektet politike është fakti që asnjëra nga partitë politike nuk ka përmendur diskriminimin dhe marginalizimin e personave LGBTIQ+ në programet e tyre. Me këtë mospërfshirje, partitë politike kanë treguar se nuk janë gati të flasin për këtë çështje publikisht, e aq më pak të propozojnë politika konkrete që do të avanconin pozitën e tyre në shoqëri.

Vlora Dumoshi thotë se në subjektin ku ajo bën pjesë ka nivel të lartë të rregullimit sa i përket aspektit gjinor. “LDK ka brenda vetes forumin e gruas, ku trajtohet çështja e grave dhe pjesëmarrja e tyre sa më e madhe në politikë. Në programet qeverisëse, kemi qenë një ndër qeveritë, rasti i qeverisë Mustafa, që kemi filuar aplikimin e ndarjes së pasurisë në familje dhe poashtu kemi ndërmarrë shumë iniciativa tjera që janë bërë nën ombrellën e zyrës për barazi gjinore”, shton ajo.

Sibel Halimi nga po i njëjti subjekt, thotë se në përgjithësi kur flitet për çështjet e grave në programe politike gjithmonë ka pasur stereotipe. “Ka ekzistuar një harmoni perfekte mes shoqërisë patriarchale dhe programeve politike”, thotë ajo.

Për të shtjelluar më tutje se pse kjo harmoni është ekzistente, Halimi merr shembuj të ndryshëm nga programe politike që në shikim te parë duken si të dobishme për gratë, por që faktikisht e dobësojnë pozitën e saj në shoqëri.

“Konsiderimi që vetëm grave u takon pushimi i lehonisë dhe shtesat përfshirë, janë elemente të cilat në pamje të parë duken sikur po i kontribuojnë gruas por në fakt nuk e bëjnë këtë. Domethënë në mënyrë indirekte e promovojnë vlerën e gruas vetëm brenda shtëpisë. Në anën tjetër kemi shembulin e sigurimit të transportit përvazat të cilat po e braktisin shkollën përfshirë mungesës së transportit. Sidomos tanë që kam punë në terren kam parë që shumë vajza e kanë braktisur shkollën vetëm sepse nuk ekziston një autobus për t'i dërguar në shkollë. Këtu mundeni me pa se sa pak janë te ndjeshme partitë politike karshi vajzave dhe grave”, shton Halimi.

Në anën tjetër Lulzim Blaka thekson se programi politik i AAK-së, si parti e djathtë e deri diku edhe konservatore, asnjëherë nuk miset prej dallimeve gjinore. “Për këtë arsy që kohë gratë në AAK kanë funksionuar si një departament bashkë me të tjerët e jo si diçka e ndarë, por e kanë kërkuar prap riaktivizimin e Aleancës së Gruas edhe partia ua ka mundësuar këtë, miëpo asnjëherë nuk është bërë dallim i tillë”, shton Blaka.

Nita Luci tregon se arsyja pse është i rëndësishëm angazhimi politik i grave është se ato mund të ndikojnë në politika institucionale. Sipas saj mungesa e gjithëpërfshirjes prodhon politika që nuk kanë parasysh grupet e marginalizuara në shoqëri. “Këtë e shohim edhe në arsim, e kemi pa qysh prej ngacmimive seksuale dhe abuzimeve me pushtetin. Në anën tjetër vërehet mungesa e përkrahjes përvazat dhe gratë qoftë në shkollim apo avancim në rrrafshin profesional të tyre”, thotë Luci.

PËR GRATË NË POLITIKË, MEDIAT SOCIALE JANË THIKË ME DΥ TEHA

■ Lucina Di Meco

Një vit pas zgjedhjeve afatmesme, në të cilat gratë fituan një numër të paparë të vendeve në Senatin dhe Shtëpinë e Bardhë dhe një vit para zgjedhjeve të para presidenciale që nga shpërthimi i lëvizjes #MeToo, është e vështirë të mos mendosh se jetojmë në një kohë të mundësive të mëdha për përfaqësimin e grave në SHBA dhe në mbarë botën.

Por edhe pse shumë gra po kandidojnë për pozita, ato zakonish përballen jo vetëm me shqyrtimin e posedimit të një roli publik, por edhe me një shkallë të madhe rreziku për shkak të mënyrave se si gratë piketohen për kërcënime dhe sulme personale përmes mediave sociale. Gratë e dinë që dhuna në internet mund të shfaqet në çdo kohë dhe në mënyrë të pa-përgjegjshme nga autorët e dhunës.

Duke marrë parasysh këtë, dua të di: A po e bëjnë rrjetet sociale më të vështirë për gratë që të hyjnë dhe të kenë sukses në fushën e politikës?

Si eksperete gjinore dhe anëtare globale në Wilson Center, fillova të kërkoj një përgjigje për këtë pyetje duke kryer intervisita me gra udhëheqëse në politikë dhe ekspertë nga 30 vende, duke rishikuar hulumtimet ekzistuese mbi këtë temë dhe duke i kërkuar Marvelous AI, firmës analitike të të dhënave për të shqyrta mbulimin që Twitter i ka bërë lajmeve mbi zgjedhjet demokratike presidenciale të vitit 2020 në SHBA.

Rezultati ishte “#ShePersisted: Women, Politics & Power in the New Media World”, një raport hulumtues global që pasqyron pamjen komplekse të mediave sociale si një thikë me dy teha për gratë politikane, duke u mundësuar atyre të angazhohen pa ndërmjetësim, por në të njëjtën kohë duke i ekspozuar ato ndaj irreziqeve të larta.

Një sondazh i kohëve të fundit me gratë parlamentare nga e gjithë bota zbuloi se 41.8% e të anketuarave kishin parë imazhe jashtëzakonisht poshtëruese apo imazhe seksuale të tyre që po përhapeshin në mediat sociale, përfshirë këtu fotomontazhe që i shfaqnin ato lakuriq.

Nga njëra anë, dhuna online kundër grave në politikë është një fenomen global, pasi që shumë nga gratë që intervistova nga vende të ndryshme si SHBA, Ukraina, Italia dhe India më thanë se kishin qenë shënjestra të sulmeve të ngashme.

Anëtarja e parlamentit ukrainas Scitlana Zalishchuk më tha: “Unë vetë kam përjetuar një situ atë të tillë, kur një llogari e rreme e prodhuar nga faqet ruse po merrej në mënyrë aktive me mediat dhe po shpërndahej nga përdoruesit ukrainas. Qëllimi ishte për të më diskredituar si politikane, me ç'rast po sugjerohej se unë bëra një premtim në një postim në Facebook që do të vrapoja lakuriq nëpër Kiev në momentin që Debaltseve, qytet në lindje të Ukrainës, do ta merrnin separatistët e mbështetur nga Rusia. “E vërtetuar” me një pamje të rreme të postimit, kjo storje qarkulloi në internet për një vit të tërë, duke më objektifikuar dhe duke distancuar diskursin mbi personalitetin tim nga fusha profesionale.”

**EDHE PSE SHUMË GRA PO KANDIDOJNË PËR POZITA,
ATO ZAKONISHT PËRBALLEN JO VETËM ME SHQYRTIMIN E POSEDIMIT TË NJË
ROLI PUBLIK, POR EDHE ME NJË SHKALLË TË MADHE RREZIKU PËR SHKAK TË
MËNYRAVE SE SI GRATË PIKE TOHEN PËR KËRCËNIME DHE SULME PERSONALE
PËRMES MEDIAVE SOCIALE. GRATË E DINË QË DHUNA NË INTERNET MUND TË
SHFAQET NË ÇDO KOHË DHE NË MËNYRË TË PAPËRGJEGJSHME NGA AUTORËT
E DHUNËS.**

Amanda Renteria, presidente e Emerge America dhe kandidate për guvernatore të Kalifornisë, më tha se gjersa punonte si drejtore politike kombëtare e fushatës presidenciale të Hillary Clinton në vitin 2016, ajo ishte piketuar nga operativët rusë me një shënim të rremë të marrë nga FBI. Pasi që kjo storje u shfaq në The Washington Post, ajo tha: "Kam marrë mesazhe me gjuhë të urrejtjes, nga grupet QAnon (grup që shpërndanë teori konspirative të së djathtës ekstreme). Sinqersht ishte një përvojë shqetësuese për ne."

Në SHBA ekzistojnë prova se gratë kandidate për president janë shënjestër e më shumë sulmeve që bëhen nga llogaritë e rreme të lajmeve të krahut të djathtë, krahasuar me burrat politikanë. Sulmet që iu bëhen atyre janë jashtëzakonisht negative dhe fokusohen në karakterin e tyre dhe jo në politikat e tyre. Një sondazh i kohëve të fundit me gratë parlamentare nga e gjithë bota zbuloi se 41.8% e të anketuarave kishin parë imazhe jashtëzakonisht poshtëruese apo imazhe seksuale të tyre që po përhapeshin në mediat sociale, përfshirë këtu fotomontazhe që i shfaqnin ato lakuriq. Sipas një artikulli të fundit nga The Guardian, gratë politikane që i përkasin pakicave fetare janë në rrezik edhe më të madh për tu bërë objektiva të fushatave dezinformuese.

Sipas drejtores ekzekutive të OKB-së, Phumzile Mlambo-Ngcuka: "Kur gratë vuajnë nga kjo dhunë në internet, qëllimi është po i njëjtë si ai në realitet, pra ti kontrollojmë, ti kemi nën pushtet, ti heshtim dhe ti mbajmë jashtë bisedës dhe duke mos i lënë të përfitojnë në mënyrë të barabartë."

Sidoqoftë, shumica e grave politikane që intervistova në mbarë botën më thanë se mediat sociale janë një mjet shumë i dobishëm për to, pasi u siguron atyre diçka që nuk e kishin më parë: aftësinë për të drejtuar narrativat e tyre, të çliruara nga seksizmi dhe marginalizimi i mediave tradicionale të cilat

i kanë bërë ato të padukshme. Comfort Doyoe Cudjoe-Ghan-sah, anëtarë e parlamentit dhe nënkyryetare e dytë e pakicës në Ganë, më tha se mediat sociale luajtën "një rol jetësor" në karrierën e saj politike, pasi i mundësuan të shfaqte punën e saj dhe të merrte mbështetje dhe inkurajim nga to, duke rrënuar "pikëpamjen negative" që kundërshtarët e saj politikë kishin paramenduar për të.

Bazuar në hulumtimet që janë në dispozicion dhe intervistat që kam bërë me strategë politikë dhe gratë politikane të cilat raportuan se kishin përdorur hapësirën në internet vetëm për avantazhin e tyre, dalin disa rekomandime dhe praktika më të mira që duhet të merren në konsideratë.

Së pari, përgjigja ndaj sulmeve dhe thirrja për seksizëm paguhet. Një studim i realizuar nga Lake Research Partners për Women's Media Center, zbuloi se kur një grua kandidate i kundërpërgjigjet seksizmit dhe reklamave negative, ajo rifiton besimin e votuesve dhe përmirëson imazhin e saj.

Së dyti, të kesh një komunitet që të mbështesin në internet dhe që janë të gatshëm për tu mobilizuar është shumë e rëndësishme. Siç shpjegon Celinda Lake, anketuese dhe stratege politike: "Megjithëse kandidatët do të marrin komente mizogjene nga kundërshtarët në internet, për shkak të profitit të tyre më të lartë në publik dhe shtrirjes së madhe të mediave sociale, përgjigjet pozitive nga gratë dhe burrat mund të mposhtin komentet negative." I tillë ishte rasti i Laura Boldrini, kongresiste italiane, e cila ishte objekt i sulmeve në internet nga burrat që po e kërcënoin ta përdhunonin dhe vrisnin: "Në momentin që i ekspozojë dhe denoncoja ngacmuesit, mijëra njerëz në internet më dolën në mbrojtje, duke konfirmuar që hapësira dixhitale është një arenë për të denoncuar seksizmin dhe për të formësuar diskursin politik."

Së fundmi, ndërveprimi me ndjekësit është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Hulumtimi mbi garat e Senatit në SHBA tregon se është e dobishme që gratë kandidate të përdorin Twitter-in në mënyrë interaktive, pasi që kishte një ndërlidhje direkte mes angazhimit të grave në internet dhe gjasave të tyre për të fituar zgjedhjet. Ndërsa, e kundërtë vlen për burrat, pasi kandidatët burra të cilët kishin fituar nuk përdornin mediat sociale në mënyrë interaktive.

Përderisa disa gra politikane kanë mundur të përdorin mediat sociale për të çuar përrapa ambicjet e tyre politike, shumë gra të reja ngurrojnë të kandidojnë për pozita për shkak të shqetësimeve në lidhje me sulmet në internet, që është një tjetër pengesë e fortë në mesin e shumë të tjerve me të cilat përballen gratë. Por, ky problem nuk është pa zgjidhje. Hulumtimi im si dhe hulumtime të tjera, përshkruajnë rekomandime të bazuara në dëshmi, të cilat nëse zbatohen do të siguronin që hapësira dixhitale të bëhej një arenë më e barabartë gjinore sa i përket angazhimit politik. Këto rekomandime përfshijnë:

- Përdorimi i inovacioneve teknologjike për të adresuar seksizmin, gjuhën e urrejtjes me bazë gjinore dhe ngacmimin në internet: Meqë algoritmet kanë luajtur një rol të quartë në përhapjen e mizo-gjinisë dhe paragjykimeve të tjera, ato mund të vendosen në mënyrë të barabartë për të rritur ndërgjegjësimin.
- Përmirësimi i llogaridhënieve së përdoruesit dhe sigurimi që kompanitë e mediave sociale të identifikojnë, gjurmognë dhe të heqin përbajtjen abuzive dhe gjuhën e urrejtjes në një mënyrë më transparente dhe të qëndrueshme.
- Ofrimi i kurseve të shkrimit-leximit të medias dhe informacionit (MIL) si pjesë thelbësore e kurrikulave shkollore për të ndihmuar të rinjtë të zhvillojnë aftësinë për të konsumuar dhe krijuar përbajtje mediatike në një mënyrë pozitive dhe efektive.
- Sigurimi që kandidatët gra në nivel global të trajnohen dhe informohen se si të përdorin mediat sociale në një mënyrë të sigurtë dhe efektive. P.sh. duke përdorur mjete si #think10, një mjet për vetëvlerësimin dhe planifikim-

in e sigurisë në internet i cili është zhvilluar nga Instituti Demokratik Kombëtar.

Pavarësisht dëshmive se institucionet me balanc gjinorë janë shumë më të forta dhe pjesëmarrja e grave në qeverisje rrit besimin e publikut në demokraci dhe zvogëlon korruptionin, pothuajse asnje nga këto rekomandime nuk po zbatohet në një shkallë të gjërë.

Përderisa, universitetet, fondacionet, filantropët miliarderë dhe grupet e kërkimit po i kushtojnë gjithnjë e më shumë rëndësi çështjes së demokracisë dhe teknologjisë dhe po investojnë miliona dollarë dhe kapacitet të konsiderueshëm mendor për të adresuar lirinë në internet, dezinformimin, gjuhën e urrejtjes, nxitjen dhe ndërryjen e huaj gjatë fushatave zgjedhore, në përgjithësi ato janë krejtësisht të pa trajtura sa i përket pikëpamjes gjinore, duke anashkaluar plotësisht shqetësimet dhe kërcënimet të cilat janë specifike dhe reale e me të cilat ballafaqohen gratë në politikë.

Është çështje kritike që investimet e mëtejshme të bëhen mbi gjurmimin dhe luftimin e fushatave dezinformuese me bazë gjinore si dhe dhunës në internet ndaj grave në politikë. Vetëm atëherë, gratë me të vërtetë do të janë në gjendje të përfitojnë nga mundësitë për ak-

tivizëm politik, shtrirje dhe angazhim gjë që ua ofron media sociale dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre politike në kushte të barabarta.

Kjo është një çështje urgjente poashtu, sepse nuk ka asnje mënyrë efektive për të larguar popullsinë e përgjithshme nga qeveria sesa të sigurohet që të parandalohet gjysma e tyre nga përfshirja në të. Sfidat globale me të cilët po përballet planeti ynë janë shumë të mëdha që të mund të mbështetemi vetëm në gjysmën e grupit që kanë talent për t'i zgjidhur ato.

Përkthyer nga QIKA

<https://www.womensmediacenter.com/news-features/for-women-in-politics-social-media-is-a-double-edged-sword>

**ËSHTË ÇËSHTJE KRITIKE QË
INVESTIMET E MËTEJSHME
TË BËHEN MBI GJURMIMIN
DHE LUFTIMIN E FUSHATAVE
DEZINFORMUESE ME BAZË
GJINORE SI DHE DHUNËS NË
INTERNET NDAJ GRAVE NË
POLITIKË. VETËM ATËHERË,
GRATË ME TË VËRTETË DO
TË JENË NË GJENDJE TË
PËRFITOJNË NGA MUNDËSITË
PËR AKTIVIZËM POLITIK,
SHTRIRJE DHE ANGAZHIM, GJË
QË UA OFRON MEDIA SOCIALE
DHE TË USHTROJNË TË DREJTAT
E TYRE POLITIKE NË KUSHTE TË
BARABARTA.**

BOTA NUK KA NEVOJË VETËM PËR LIDERE GRA – KA NEVOJË PËR LIDERE/Ë FEMINIST

■ Audrey Azoulay
■ Katrín Jakobsdóttir

Në vitin 2021, po i vërejmë shumë mënyra se si Covid-19 ka ndikuar në mënyrë disproporcionale tek gratë dhe vajzat në gjithë botën. Pandemia ka krijuar një situatë të re. Edhe pse gratë kanë luajtur rol të rëndësishëm në përgjigjen kundër kësaj krize, pabarazia gjinore u rrit në të gjithë botën. Në fushën e arsimit, 767 milion gra e vajza u ndikuan nga mbyllja e shkollave. Njëmbëdhjetë milion mund të mos kthehen kurrë më në banka shkollore duke iu bashkuar kështu 132 milion të tjerave të cilat ishin jashtë shkollës edhe përparrë se të fillonte kriza. Situata e rënduar ekonomike është duke shtyrë 47 milion gra e vajza drejt varférësë, duke iu dëmtuar kështu pavarësinë ekonomike dhe duke i bërë edhe më të cenueshme ndaj diskriminimit dhe dhunës në baza gjinore.

Kur shohim këtë situatë duhet ta pyesim veten: nëse barazia gjinore është qëllimi jonë, përfshirë lloji të udhëheqjes ka nevojë bota përfshirë ecur përparrë?

Nuk është e mjaftueshme që thjesht të numërojmë gratë nëpër pozita të larta të pushtetit. Asnjë person në maje të piramidës nuk mund të riparoj dëmin që i është bërë procesit përfshirë barazi gjinore të nisur që nga koha kur u miratua Deklarata e Pekinit përfshirë drejtat e grave para 25 viteve.

Neve na nevojiten liderë përfshirë barazi gjinore - dhe kemi nevojë përfshirë ta kudo në strukturat tona shoqërore. Lidherë të të gjitha moshave, të gjitha identitetet gjinore dhe nga të gjitha fushat. Këta liderë nuk janë thjesht agjentë të ndryshimit, por edhe projektuesit e tij. Ata

**NEVE NA NEVOJITEN LIDERË
PËRFSHIRË BARAZI GJINORE – DHE
KEMI NEVOJË PËRFSHIRË TA KUDO NË
STRUKTURAT TONA SHOQËRORE.
LIDERË TË TË GJITHA MOSHAVE,
TË GJITHA IDENTITETEVE GJINORE
DHE NGA TË GJITHA FUSHAT.
KËTA LIDERË NUK JANË THJESHT
AGJENTË TË NDRYSHIMIT, POR
EDHE PROJEKTUESIT E TIJ. ATA
DHE ATO UDHEHEQIN PËRMES
SHEMBULLIT DHE ANGAZHIMIT TË
TYRE. ATA DHE ATO EKSPOZUJNË
MUNDËSITË E PABARABARTA DHE
PADREJTËSITË. POASHTU E DINË QË
PABARAZITË GJINORE BUROJNË NGA
DISKRIMINIMI DHE PËRJASHTIMI
DHE SE VETËM ME HEQJEN E KËTYRE
BARRIERAVE MUND TË BËHEN
NDRYSHIME TË VËRTETA. KJO ËSHTË
UDHEHEQJE FEMINISTE.**

dhe ato udhëheqin përmes shembullit dhe angazhimit të tyre. Ata dhe ato ekspozoinë mundësitet e pabarabarta dhe padrejtësitë. Poashtu e dinë që pabarazitë gjinore burojnë nga diskriminimi dhe përjashtimi dhe se vetëm me heqjen e këtyre barrierave mund të bëhen ndryshime të vërteta. Kjo është udhëheqje feministe.

Lideret dhe liderët feministë sulmojnë strukturat e pushtetit. I vënë në shesh dhe prishin të gjitha format e përjashtimit dhe marginalizimit. Ata dhe ato kanë empati për të cënuarit dhe të pazëshmit, dhe i përkrahin kauzat e tyre. Hapin dyer të reja dhe marrin rreziqe, guximshëm tërheqin vëmendjen tek pabarazitë e fshehura dhe i demaskojnë barrierat strukturore që përjetësojnë pabarazinë. Ata dhe ato janë kudo rrëth nesh. Qoftë kjo aktivistja që mbron një komunitet indigen, qoftë nxënësja që mobilizon brezin e saj për të mbrojtur botën nga ngrohja globale apo poetja që ngreh zërin për të promovuar drejtësi sociale.

Liderët feministë kanë kurajo për të krijuar, raportuar, edukuar e eksperimentuar. Mendo për Azata Soro, aktoren, regjisoren dhe producenten e cila theu heshtjen për ngacimim seksual dhe dhunën në industrinë e filmit afikan. Mendo për Maria Ressa që rrezikoi të burgosej për gazetarinë e saj humtuese të guximshme. Mendo për Yande Banda, avokate e palodhur për çështjet e edukimit të vajzave në Zambia e më gjerë. Mendo për Katalin Karikó e cila i kapérceu sfidat e shumta me të cilat përballen gratë në shkencë e që ishte shumë e rëndësishme në zhvillimin e vaksinës së coronavirutis - Pfizer-BioNTech. Kur ngjarje të tillë bëhen të njoitura, ato sfidojnë bindjet e njerëzve rrëth asaj se çka është e arritshme dhe kush mund ta arrijë atë. Të gjitha këto gra, me gjithë laramaninë e tyre, janë lidere feministe.

Sidoqoftë, udhëheqja feministe nuk është privilegji vetëm i grave. Barazia gjinore nuk është një luftë vetëm e grave, është luftë për barazi sociale. Edhe burrat duhet të përfshihen në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë. Shumë prej tyre po i prijnë kësaj rruge. Gjinekologu kongolez, Dr. Denis Mukwege, ka fituar çmimin nobel për paqe për avokimin e tij kundër përdorimit të përdhunimit si “armë lufte”. Ka shumë të tjerë si ai në gjithë botën. Në këtë ditë ndërkombëtare të grave, jemi të përkushtuar për të ndërtuar gjenerata të ardhshme të liderëve feministë përmes arsimit. Ne i mbështesim gratë të cilat patën guxim të krijonin e të bënin gjithçka që ishte e nevojshme për t`i parandaluar cenzurat dhe sulmet kundër tyre. Ne i bëjmë thirrje bashkësisë ndërkombëtare që të sigurojë mbrojtjen e grave gazetare që adresojnë pabarazitë gjinore përmes raportimeve. Ne gjithashtu qëndrojmë përkrah me burrat që guxojnë të kujdesen dhe refuzojnë sjelljet dhe maskulinitetin toksik dhe krijojnë hapësira për gratë që të ndikojnë në vendimmarrje ose të marrin pjesë në zbulimin dhe inovacionin shkencorë.

Le të mbështesim lideret dhe liderët feministë nga të gjitha rrugët e jetës. Le të veprojmë ashtu që gratë të mund të udhëheqin dhe të bëhen shembull për gjeneratat që po vijnë.

Përkthyer nga QIKA

<https://www.commondreams.org/views/2021/03/08/world-not-only-needs-women-leaders-it-needs-feminist-leaders?fbclid=IwAR1bG90nlBy-RSrmU1i61WelmJnxoXDu2Y8tAfr6LS1Vu06EDntWJV3D7II>



ASGJË NUK ËSHTË MË MIZOGJENE SESA DEFINIMI I FEMINIZMIT SI BARAZI PËR TË GJITHË

■ Marcie Bianco

Semestrin e kaluar, u kërkova studentëve të mi të definonin “feminizmin”. Të gjithë e lidhën me fjalën “barazi”, “barazi për gratë”, “barazi për të gjitha gjinitë”, “barazi në vendin e punës”. Por, klasa ra në heshtje kur i pyeta se çfarë nënkuptonte barazia për ta dhe si shfaqej ajo. Fjala barazi është bërë e zbrザet duke nënvisuar një problem të madh definitivi krasas lëvizjes së grave.

Studentët e mi e dinin që kuotat e rrepta të punësimit nuk janë një zgjidhje afatgjatë për seksizmin, njëloj siç kuptuan se barazia sipas ligjit nuk siguron trajtim të barabartë të grave. Në qytetin e New York-ut, ligjërisht gratë mund të ecin lakuriq në pjesën e sipërme, por asnjë nga studentet e mia nuk thanë se do të përfitonin nga kjo barazi ligjore, pasi që ato nuk donin të përballeshin me ngacmimë ose sulme seksuale.

Në epokën e feminizmit të të famshmeve dhe burrave performues feministë, ideja se feminizmi ka të bëjë me “barazinë për të gjitha gjinitë” është bërë gjithnjë e më në modë. Megjithatë, përmua asgjë nuk është më Mizogjene sesa definitivi i feminizmit si barazi për të gjithë, gioja se të përqendrosh një lëvizje, politikë apo aktivizëm vetëm tek gratë është tabu. Ose shumë e rezikshme. Përgjigja automatike refuzuese “të gjitha jetët kanë rendësi” për t'i përqendruar gratë në këtë përsëritje të fundit të feminizmit, besoj që është një shkak i rendësishëm se pse ka ngecur revolucioni gjinor. Ne nuk mund të adresojmë ose t'i japim fund shtypjes sistemike të grave nëse refuzojmë të pozicionohemi si gra në atë luftë. Kjo do të thotë të rishqyrtojmë atë që nënkuftojmë kur flasim për barazi dhe pushtet.

Ideja se feminizmi ka të bëjë me “barazinë për të gjitha gjinitë” është gjithnjë e më në modë. Në mënyrë që të kemi sukses, feminizmi duhet të punojë brenda vetë sistemeve që gratë duan t'i ndryshojnë. Kjo do të thotë që gratë duhet të rishqyrtojnë marrëdhënien e tyre me pushtetin dhe strukturat e tij.

Feminizmi në epokën dixhitale e ka pozicionuar veten në kundërshtim me pushtetin, qoftë i shfaqur përmes mantras së hashtag-ut #Resist, apo përmes gjendjes së “fuqisë së gruas”. Gratë ndihen më rehat me protestimin dhe “rezistencën” sesa të udhëheqin, sepse udhëheqja kërkon që të punojmë për të reformuar vetë strukturat që na shtypin. Pushteti është kompleks, por në vettete nuk është negativ dhe nuk ka pse t'i dorëzohet zotërimi të patriarkatit. Po citoj filozofen feministë Elizabeth Grosz, “Nëse feministët besojnë se qëllimi i tyre është të braktisin pushtetin, atëherë ata tashmë kanë humbur lojën nga e cila nuk mund të tërhiqen.”

Lidhja e vështirë e feminizmit me pushtetin është diçka që gratë konservatore si Kellyanne Conway e theksojnë kur e përqeshin si një lëvizje “kundër burrave” e cila përbëhet nga gra të cilat “kanë problem me pushtetin”. Narrativa se feminizmi është “kundër burrave” është keqinterpretim i qëllimshëm që synon të dëmtojë lëvizjen. Por, Conway dhe të tjerët kanë të drejtë të vëzhgojnë lidhjen antitetike të lëvizjes në raport me pushtetin. A është pushteti në vettete patriarchal? Si e marrin dhe e përdorin gratë këtë pushtet? Për ta shtyrë çështjen edhe më tej, a është ligjërimi kulturor pseudo-feminist rrëth “fuqizimit” një njohje e dështimit të grave për të pasur në të vërtet pushtet? Sepse nuk të rastisë të dëgjosh burrat duke folur për fuqizim ose të ndihen të fuqizuar.

Njerëzit që kanë pushtet nuk ëndërrojnë për fuqizim.

Në filozofji, liria e mendimit është forma përfundimtare e çlirimt. Në kontekstin e pushtetit, të imaginuarit se si ne mendojmë mbi pushtetin është hapi i parë themelor për të çrrënjosur shtypjen sistematike të grave. Si forcë, pushteti nuk është në thelb sekst. Por historikisht është shfrytëzuar për të përjetësuar shtypjen e grave. Nëse e kuptojmë që pushteti nuk njeh gjini dhe që gratë mund të janë të pushtetshme, atëherë ne mund të përmbysim narrativat tradicionale që kanë vendosur feminizmin në një cikël rrotullues për 100 vitet e fundit.

Për të qenë politikisht efikas, feminizmi varet para së gjithash nga një ri-kalibrim i mendjeve të grave. Feminizmi kërkon liri, liri intelektuale dhe rrjedhimisht kërkon liri trupore. (Kjo është arsyëja pse unë besoj se nuk mund të jesh kundër zgjedhjes për abort dhe ta quash veten feminist). Gjithashtu, kjo është mënyra se si feminizmi filloj si lëvizje në fillim të shekullit XX, i dallueshëm nga objektivi i vetëm i çështjeve sufragente (përpjekjet për të siguruar lirinë e grave për votë) në atë kohë. Është çështje kritike të mbahet mend se përderisa të gjitha feministet mbrojtën të drejtën e votës, jo të gjitha sufragjetet ishin feministë.

Si forcë, pushteti nuk është në thelb sekst. Por, është shfrytëzuar historikisht për të përjetësuar shtypjen e grave. Argumenti im është se pushteti është lidhja që mungon midis shpresës dhe ndryshimit. Pra, si mundemi ne si feministë të përpinqemi të ri-imaginjmë dhe të ri-orientohemi pozitivisht drejt pushtetit kur për kaq shumë kohë jemi kushtëzuar ta refuzojmë atë, kur ndihemi më rehat të rezistojmë sesa të udhëheqim në këtë botë?

Së pari, një lëvizje e suksesshme e grave në Amerikë duhet të jetë aleate me 99%-shin dhe 1%-shin, me gratë e zeza dhe gratë e bardha, gratë heteroseksuale dhe gratë lezbike. Çdo aktivizëm që i vë gratë kundër njëra-tjetrës nuk është feministë, sepse motërimi është mjeti ynë më i fuqishëm. Edhe burrat në pushtet e dinë

këtë, kjo është arsyja pse ndarja e grave dhe shfaqja e përplasjeve në media është një mënyrë e sigurt për t'i mbajtur gratë të shtypura. Për aq kohë që gratë luftojnë me njëra-tjetren, ato nuk po luftojnë kundër strukturave më të mëdha që i mbajnë ato të shtypura.

Së dyti, ne duhet ta përqafojmë feminizmin si një lëvizje politike dhe lëvizje e drejtësisë shoqërore, si aktivizëm nga brenda dhe jashtë institucioneve. Marshet dhe protestat përfaqësojnë një taktkë në strategjinë më të madhe të shkatërrimit të shtypjeve sistemike që prekin gratë, ndërsa ndryshimi i politikave që adresojnë paragjykimet e pavetëdijskme në vendin e punës dhe çështja e të drejtave janë taktkë tjetër. Në kemi nevojë për të dyja taktit. Kemi nevojë për taktit e rezistencës dhe për taktit operacionale për të krijuar ndryshime në të gjithë sistemin.

Në mënyrë që çdo lëvizje e drejtësisë shoqërore të zhvillohet, ajo duhet të ushqehet nga ide dhe vizion. Politika duhet të shoqërohet dhe paraprihet nga një zgjim etik brenda individëve. Strategja e vetme historike e feminizmit që një-kohësish është një imperativë filozofike është kultivimi i mendimit të pavarur. Mendimi i pavarur i fituar përmes arsimimit rigoroz është bastioni i liberalizmit dhe nënvizon në mënyrë specifike parimin e lirisë. Nga Mary Wollstonecraft në shekullin XVIII dhe J.S Mill në shekullin XIX, Simone de Beauvoir në shekullin XX deri tek Chimamanda Ngozi Adichie në shekullin XXI, liria e grave fillon me arsimimin e tyre, i cili jo domosdoshmërisht duhet të jetë institucional.

Vetëdija e plotë e grave për pozicionin e tyre në botë, mënyra se si lokalizohet historia e shtypjes në trupat e tyre, ndodhë kur ato kuptojnë se kanë qenë të pavëmendshme për këtë gjë gjatë gjithë kohës. "Nxitja e jetës së re, zgjimi i prekshëm i ndërgjegjes" është mënyra se si një shkrimtar raportoi për idenë e re të feminizmit në një artikull të vitit 1913 për Harper's Weekly. Ky zgjim pëershruan procesin e të mësuarit.

Politika duhet të shoqërohet dhe paraprihet nga një zgjim etik brenda individëve. Më pak se një shekull pasi J.S. Mill shkroi se infantilizmi intelektual i grave ishte një mënyrë për ti shtypur ato, me ç'rast Simone de Beauvoir katalogoi "si gratë mësohen të supozojnë gjendjen e saj" të nënshtrimit në trajktoren ekzistenciale feministe, në Seksin e Dytë (1949). Është pikërisht

Beauvoir ajo që frymëzoi feministë të panumërtë amerikane, përfshirë Audre Lorde, e cila citoi feministen franceze në fjalimin e saj të famshëm "The Master's Tools Will Never Dismantle the Master's House." Sepse, përdorimi i mjeteve dhe gjuhës pa munduar dhe në mënyrë jo-kritike, "kurrë nuk do të na mundësojë të bëjmë ndryshime të vërteta" paralajmëroi Lorde.

Mendimet e Chimamanda Ngozi Adichie rrëth mënyrës se si kushtëzimet historike shoqërore ndikojnë në psikologjinë e mendjes janë të ngashme me ato të shkruara nga Beauvoir. Në

përbledhjen e saj "We Should All Be Feminists" (2014), e cila u popullarizua në këngën e Beyoncé-s "Flawless", Adichie poashtu shpjegon kushtet sociale të grave: "Ne i mësojmë vajzat si të ngurren." Njëloj si Beauvoir dhe feministet para saj, ajo e gjen zgjidhjen në thyerjen e zinxhirit të shtypjes në mendje dhe konkretisht përmes të një ri-trajnimi të mendjes. "Ajo që ka rëndësi edhe më shumë është qëndrimi ynë, mendësia jonë", pohon Adichie në shtjellimin e saj se si gjinia pëershruhet si moral. "Problemi me gjininë është se pëershruan se si duhet të jemi sesa të kuptojmë se si jemi."

Feminizmi si politikë është një lëvizje mes njerëzve, por si etikë fillon si një lëvizje brenda vetes. Unë mendoj se kjo është pika nga e cila duhet të fillojmë: brenda vetes. Presioni shoqëror dhe konfromiteti nuk janë cilësi

të mendimit të pavarur por janë shenja të rrezikshme të fashizmit dhe rënies kulturore. Në vend që të marrim përkufizimin e feminizmit si një të vërtetë, ne duhet të pyesim se çfarë është dhe çfarë do të thotë feminizëm në këtë shekullin e ri. Ne duhet të vëmë në dyshim kuptimin e fuqizimit dhe të kërkojmë pushtet në vend që të punojmë për ta gjerryer atë tek të tjerët. Ne duhet të vëmë në dyshim barazinë dhe nëse nuk duhet të zëvendësojmë këtë ideal të dëshiruar me atë të lirisë. Ne duhet të vëmë në dyshim impulsin për të decentralizuar gratë. Ne duhet të imagjinojmë se si duket feminizmi në veprim, në politikë dhe në shoqëri. Dhe vetëm atëherë ne duhet të zhvillojmë strategji për të arritur ato qëllime.

Sepse e ardhmja e ekzistencës së grave varet nga kjo.

Përkthyer nga QIKA

<https://finance.yahoo.com/news/gender-revolution-stalled-because-feminists-133451081.html>

